

QELESHJA SHQIPTARE – ZANAFILLA E QYTETËRIMIT PELLAZGJIK TË DODONËS

Kujtim MATELI

Studiues, Akademia “Rrënjët Tona”

PËRMBLEDHJE

Tre gjetje arkeologjike që i përkasin shekullit të katërt para Krishtit. Cyla dyjare dhe qeleshja e banorëve të Shqipërisë së jugut gjendet në këto treva të banuara prej tyre në gjetjet arkeologjike të shekullit të IV-ërt para Krishtit. Popujt në rrjedhë të historisë përmirësojnë gjuhën dhe kulturën materiale, përsosin traditat dhe zakonet. Çdo popull dallohet nga një popull tjetër pikërisht nga këto elementë. Ndërsa gjuha është tipari kryesor i dallimit të një etnie nga një tjetër, nuk janë të parëndësishme edhe dallimet e tjera të jetës materiale, të traditave dhe zakoneve të formësuara në një mjedis të caktuar. Popujt janë dalluar edhe nga veshja që ata kanë mbajtur. Ky dallim shtrihet edhe midis krahinave të së njëjtës etnie. Një mënyrë e caktuar veshje ka ardhur si trashëgimi nga njëri brez në tjetrin. Qeleshja e bardhë dhe cyla dyjare karakteristike e banorëve të Shqipërisë së jugut, deri në cilin segment kohor e ka zanafillën e saj? Kësaj pyetjeje i përgjigjen tre gjetje arkeologjike në luginën e Carakovistës që i përkasin mesit të shekullit të IV-ët para Krishtit. Gjetja arkeologjike në luginën e Carakovistës, të zbuluara nga Karapano, që i përket Planche nr. 10, figura 2, tregon një burrë që mban në kokë një qeleshe me majë. Kjo qeleshe është e ngjashme me atë që trevat e jugut të Shqipërisë e kanë patur në veshjen e tyre karakteristike. Gjetja e dytë arkeologjike është ajo e Planche nr. 15, bas-reliev mbi një pllakë bronzi ku janë dhënë dy luftëtarë. Fituesi që i përket ushtrisë vendase ka në kokë një qeleshe, të ngjashme me qeleshen e Planche nr 10, figura 2. Ushtari i shtrirë përtokë që simbolizon humbësin, është pa kësulë në kokë, që tregon se qeleshja ishte vetëm pjesë e veshjes së banorëve epirotë. Pra banorët e trevave të Shqipërisë së jugut e kanë mbajtur qeleshen si pjesë të veshjes së tyre, e dokumentuar që prej 2400 vjetësh. Gjetja e tretë arkeologjike është ajo e planchet nr. 10, figura 2. Kjo statujë tregon një person duke luajtur në një cylë dyjare. Vijmë kështu tek një tjetër instrument muzikor që është shumë i përhapur në Shqipërinë e jugut. Të tria këto gjetje arkeologjike si pjesë e veshjes tradicionale dhe e instrumentave muzikorë nga ditët e sotme e deri në shekullin e katërt para Krishtit, tregon se shqiptarët e kanë ruajtur mirë identitetin e tyre dhe njëkohësisht tregon se banorët e Shqipërisë së jugut janë zotër të këtyre trojeve edhe para shekullit IV-ërt, e cila vërtetohet nga qeleshja e këtyre banorëve që nga kohët homerike. Akil Pelindi, luftëtar i shquar i Luftës së Trojës që ishte me origjinë pellazge, mbante në kokë një qeleshe. Pasaportën pellazge Akil Pelindit ia ka dhënë Homeri që në vargun e shtatë të Iliadës e quante Akil Hyjnori, epitete që e kishin vetëm pellazgët. Po kështu dhe Odisea quhet nga Homeri, Odise Hyjnori, edhe ai mbante një qeleshe në kokë. Qeleshja vërteton se raca pellazgo-ilire e deri në ditët e sotme, janë dalluar nga popujt e tjerë edhe nga veshja e tyre me qeleshe në kokë.

Fjalë kyçe: qeleshe, Dia, Dodona, trevat shqiptare, 2400 vite para Krishtit.

ABSTRACT

Three archaeological finds belonging to the fourth century BC. Cyla dyjare and qelesh of the inhabitants of southern Albania is found in these areas inhabited by them in the archaeological findings of the IV century BC. Peoples in the course of history improve language and material culture, refine traditions and customs. Every people is distinguished from another people precisely by these elements. While language is the main feature of distinguishing one ethnicity from another, other differences in material life, traditions and customs formed in a given environment are not insignificant. Peoples are also distinguished by the dress they wear. This difference also extends between the provinces of the same ethnicity. A certain way of dressing has come as a legacy from one generation to the next. The white qelesh and cyla dyjare

characteristic of the inhabitants of southern Albania, up to which time segment has its origin? This question is answered by three archeological finds in the Carakovista valley belonging to the middle of the 4th century BC. Archeological find in the Carakovista valley, discovered by Karapano, belonging to Planche No. 10, figure 2, shows a man holding a pointed qeleshe on his head. This qeleshe is similar to what the southern regions of Albania have had in their characteristic clothing. The second archeological find is that of Planche no.15, bas-relief on a bronze slab where two warriors are given. The winner who belongs to the local army has a qeleshe on his head, similar to the qeleshe of Planche No. 10, figure 2. The soldier lying on the ground symbolizing the loser, is without a hat on his head, indicating that the qeleshe was only part of the clothing of the Epirote inhabitants. So the inhabitants of the territories of southern Albania have kept the qeleshe as part of their clothing, documented for 2400 years. The third archeological find is that of planchet no. 10, figure 2. This statue shows a person playing on a double cyle._Thus we come to another musical instrument that is very widespread in southern Albania. All three of these archeological findings as part of the traditional clothing and musical instruments from today to the fourth century BC, show that Albanians have well preserved their identity and at the same time show that the inhabitants of southern Albania are masters of these lands even before the 4th century, which is evidenced by the Qelesh of these inhabitants since Homeric times. Achilles Pelindi, the most prominent warrior of the Trojan War, who was of Pelasgian descent, wore a qeleshe on his head. The Pelasgian passport was given to Achilles Pelind by Homer, who in the seventh verse of the Iliad called him dios Achilles, an epithet that only Pelasgians had. The Pelasgian passport Achilles Pelind gave to Homer who in the seventh verse of the Iliad called dios Achilles an epithet that only the Pelasgians had. Likewise and Odysseus is called by Homer, dios Odysseus, also he wore a qeleshe on his head. Qeleshja confirms that the Pelasgian-Illyrian race to the present day, have been distinguished from other peoples by their wearing of qelesh on the head.

Key words: *Hats, Dia, Dodona, Albanian territories, 2400 years BC.*

QELESHJA SHQIPTARE – ZANAFILLA E QYTETËRIMIT PELLAZGJIK TË DODONËS

Në një studim rëndësi të dorës së parë kanë burimet të cilat shërbejnë si dëshmi në vërtetim e një teze. Tri gjetjet arkeologjike të Luginës së Carakovistës janë të certifikuara nga Konstantin Karapanos në studimin e tij paraqitur para institucionit shkencor francez dhe recesentit të këtij studimi *M. le Baron de Witte*. Gjetja e statujës së Dias së Dodonës në Apolloni, mbishkrimet e shumta që janë gjetur në çdo qytet ku Dia nderohej me një epitete të veçantë, vërtetonte se qytetet e Epirit dhe Ilirisë e nderonin kryehyjninë Di, krahas nderimit që kishin dhe për hyjnitë e tjera. Mbështetur mbi këto burime të sigurt, shohim shtrirjen gjeografike të Dias së Dodonës e cila fillon me Gjirin e Ambraqisë që shenjonte kufirin jugor të Epirit dhe deri në Veriperëndim të Malit të Zi. Statuja e Dias së Dodonës me qeleshe dhe mbajtja e saj në të gjitha trojet shqiptare vërtetonte se Hyjnia Di është nderuar në të gjithë territorin ku kanë banuar paraardhësit e shqiptarëve që ishin pellazgët dhe ilirët. Metoda e kërkimit shkencor është ajo krahasuese dhe historike.

Materiali i mbledhur për shtrirjen gjeografike ku mbahet qeleshja në ditët e sotme vërtetonte se banorët e Epirit antikë janë banorët e Shqipërisë së Jugut. Shoqëria njerëzore u formua si shoqëri, kur njerëzit filluan të mblidhen rreth një tempulli, i cili e nxori individin nga jeta e përditshme duke ia zgjeruar dimensionin tokësor dhe duke e futur në një dimension të ri që ishte ai hyjnor. Nga dimensionin hyjnor, jeta tokësore mori tjetër përmasë, shoqërisë iu çelën vizione të reja. Njerëzit kishin për model Hyjninë. Përderisa hyjnia Di e Dodonës mbante në kokë një qeleshe, ajo u bë veshje e gjithë adhuruesve të tij në të gjitha periudhat historike duke ardhur deri në ditët e sotme. Kjo lidhje e pazgjidhshme e shqiptarëve me qeleshën që e ka zanafillën te qytetërimi i Dodonës, vërtetonte se janë paraardhësit e shqiptarëve themeluesit e Dodonës

pellazgjike dhe mbajtësit e saj deri në shekullin e katërt të pas Krishtit, kur ajo u shkatërrua nga perandoria romake.

Gjetja e parë arkeologjike në luginën e Carakovistës

Pl. X, nr 2 dhe 2 e përsëritur (Përshkrimi i statujës nga M. le Baron de Witte). Personazh mbretëror (Pelops?) ulur. Në kokë mban një kësulë me majë, i mbështjellë me një pallto që i mbulon krahët dhe duart, vetëm këmbët janë lakuriq.

Fig. - 1 Banorë të Epirit me qeleshe

Dora e djathtë është e ngritur në lartësinë e gjoksit, kurse e majta është e ulur. Flokët gërsheta i bien pas, gjer mbi shpatulla. Në anën e majtë është varur një shpatë. Punë e shekullit të gjashtë para Krishtit. Lartësia 8 cm.



Koment:


Kjo statujë ka në kokë një kësulë që në ditët e sotme quhet qeleshe. Kjo tregon se burrat në antikitet mbanin në kokë një qeleshe. A ka në ditët e sotme ndonjë krahinë që e ruan këtë traditë të antikitetit? Kjo lloj qelesheje ruhet në Shqipërinë e jugut nga ajo popullsi që në ditët e sotme quhen lebër dhe çamë. Po të dy këto krahina, Labëria dhe Çamëria zënë të gjithë bregdetin, nga Preveza e deri në bregdetin e Vlorës. Ja tek vijmë tek një dëshmi e rëndësishme që vërteton se popullsia e sotme e Shqipërisë së Jugut, e ruan fare mirë qeleshen e antikitetit, çfarë vërteton vazhdimësinë e asaj popullsie të antikitetit që quheshin thesprotë, mollosë, kaonë, parauej etj, deri në ditët e sotme që është popullsia e Shqipërisë së jugut. Qeleshja gjendet në të gjitha trevat shqiptare. Kjo do të thotë se Epiri dhe Iliria i përkasin së njëjtës etnie, përderisa qeleshen e kishin veshjen e tyre të përbashkët.

Gjetja e dytë arkeologjike në luginën e Carakovistës

Planche XV. (Përshkrimi i plakës së bronzit nga M. le Baron de Witte) Grup i kompozuar me dy luftëtarë; që të dy janë lakuriq. Fituesi e ka kokën të mbuluar nga një kaskë në formë konike. Ai mban mbi supë një (Chlamyde) klamidë që mbështillet rrotull krahut të majtë në të cilin është varur një mburojë e madhe.

Fig. - 2 Ushtar epirot me qeleshe

E parë nga përpara, ai mbështet gjurin e djathtë mbi kraharonin e kundërshtarit, rrëzuar në këmbët e tij. Pllaka, duke qenë e thyer dhe e gjymtuar në shumë vende, bën të mos mund të përcaktohen armët që të dy luftëtarët mbanin në duar. Fituesi mbante ndoshta një shpatë. Ky grup, nga më të bukurit e stilit helen, zbukuron një **geniastere** të kaskës. Në raport me artin, ndoshta është superior me bronzet e Sirisë, ruajtur në Muzeun Britanik dhe ilustruar nga Brondsted. I përket fundit të shekullit të katërt para erës sonë. Lartësia 17 cm.



Koment:

Ajo që të bie në sy janë dy luftëtarët. Njëri fituesi, i cili qëndron në këmbë dhe tjetri humbësi që qëndron poshtë gjunjëve të tjetrit. Kuptohet që fituesi është një epirot dhe humbësi një nga armiqtë e Epirit. Identitetin e fituesit e përcakton mbajtja në kokë e një qelesheje që sot mbahet nga banorët e Labërisë dhe të atyre të Çamërisë. Humbësi nuk e ka mjetin mbrojtës në kokë, me anën e të cilit mund ta identifikonim se ushtarin e cilit vend përfaqësonte. Po kjo është një vepër arti dhe humbësi përfaqëson cilindo vend me të cilin është ndeshur ushtria epirote. Kjo është arsyeja që humbësit nuk i është vënë në kokë një kaskë. Qelesha e luftëtarit fitues është identike me qeleshen që mbajnë sot banorët e jugut të Shqipërisë. Provë e sigurt se banorët e Shqipërisë së sotme janë pasardhësit e drejtpërdrejt të asaj popullsie që në antikitet quhej epirote

Gjetja e tretë arkeologjike në luginën e Carakovistës

Planche nr XII (Përshkrimi i statujës nga M. le Baron de Witte)
Planche XII, nr. 4. (Përshkrimi i statujës nga M. le Baron de Witte)
Zeusi plotësisht lakuriq, duke mbajtur rrufenë në dorën e djathtë dhe duke shtrirë krahun e majtë. L'archaïsme de ce bronze n'est qu'afecte et apparent. Imitimi në këtë mënyrë i shekujve të mëparshëm në këtë staujz është jo i natyrshëm dhe i sipërfaqshëm. Realisht i përket një epoke ku kërkohet të imitoheshin format e artit primitiv, ndoshta i përket shekullit të tretë ose të dytë para Krishtit. (Lartësia 11 cm 13).



Fig. - 3 Dia i Dodonës me qeleshe

Koment. Hyjnia Di (për helenët Zeus) nuk nderohej vetëm në këtë qytet, por në të gjitha qytetet e Epirit. Do të ishte rast i veçantë nëse ky qytet nuk do të kishte dëshmi që ta lidhnin me Hyjninë Di. Hyjnia Di mban në kokë një qeleshe, ndryshe nga Zeusi helen dhe Jupiteri romak që nuk e kanë një qeleshe në kokë.

Hapësira gjeografike ku mbahet sot qelesha shqiptare deri te zanafilla e saj

Sot qeleshen e gjejmë që nga Presheva në skajin më verilindor të trojeve të sotme shqiptare e deri në Çamëri, nga Shkupi e deri në brigjet e Adriatikut dhe Jonit. Ajo është pjesë e veshjeve tradicionale në çdo krahinë të Shqipërisë.

Fig. - 4 Banorë të trojeve shqiptare me qeleshe

Qelesha është bërë pjesë e rëndësishme e identitetit të shqiptarëve. Burrat që nuk mbanin qeleshe, nuk ishin të së njëjtës rëndësie me të tjerët. Ndaj qelesha ka qenë pjesë e pandarë në veshjet e përditshme të familjeve shqiptare. Ajo që kërkohet të dimë është se kur e ka zanafillën qelesha shqiptare? Koha e përdorimit të saj shkon në të njëjtën periudhë historike, kur edhe është formuar etnia jonë që njihet me emrat pellazge dhe ilire. Gjuha ka një vatër ku lind dhe pastaj njerëzit e asaj vatre shpërndahen në territorin përreth saj. Ata komunikojnë midis tyre, quhen njerëz të një gjaku dhe ruajnë tradita e zakone të përbashkëta të origjinës, të vatrës së tyre. Kjo ka ndodhur me të gjithë popujt, kjo ka ndodhur edhe me shqiptarët. Vatra e krijimit të shqipes është Dodona. Atëherë edhe vatra e qeleshes është Dodona, sepse shtrirja e saj përputhet me territoret ku sot banojnë shqiptarët. Nëse qelesha do të ishte produkt i mëvonshëm se koha, kur Dodona shenjoi lindjes e gjuhës shqipe, atëherë do të përdorej në një territor të kufizuar, ashtu siç janë dhe veshjet e tjera që ndryshojnë nga njëra krahinë te tjetra. Lindja e Dodonës shenjohet bashkë me lindjen e hyjnisë së saj që ishte Dia, i cili mban në kokë një qeleshe.



Gjetjet arkeologjike nga Gjiri i Ambraqisë e deri në Risan (Rizon), në veriperëndim të Malit të Zi, vërtetojnë se në këto territore iliro-epirote nderohej Dia i Dodonës. Të gjitha mbishkrimet e gjetura vërtetojnë se emri i Hyjnisë në këto territore quhej Di, që është i ndryshëm nga ai helen që quhej Zeus. Në identitetin e një populli në antikitet gjuha dhe besimi kanë qenë dy elementët më të rëndësishëm që e dallonin një popull nga një tjetër. Pellazgo-ilirët e kishin hyjninë e tyre të dallueshme nga popujt e tjerë. Një nga këto tipare dalluese, te iliro-epirotët, ishte qelesha me të cilën ata e identifikonin Hyjninë e tyre. Kjo është arsyeja që ata e bënë qeleshen pjesë të veshjes së tyre. Dalloheshin nga popujt e tjerë jo vetëm nga gjuha, por edhe nga qelesha që mbanin në kokë. Edhe për pellazgët, edhe për ilirët perëndia kryesore ka qenë Dia i Dodonës, përderisa ata identifikoheshin me qeleshin e Dias së Dodonës.

Krijimi i gjuhës shqipe dhe Dia i Dodonës janë binjake të njëra-tjetrës

Hyjnia e Dodonës e zhvilloi gjuhën shqipe me fjalë të reja që lidheshin përtej jetës së tyre. Me lindjen e Hyjnisë dodonase u krijua dimension i hyjnor, i cili kërkonte fjalë të reja për ta shprehur atë. Lindja e Hyjnisë Di dhe e hyjnine të tjera dodonase shënon një hap të rëndësishëm jo vetëm në zhvillimin e shoqërisë njerëzore, por edhe në zhvillimin gjuhësor. Njeriu po njihej me një tjetër dimension përtej asaj që i përcaktonte atij jeta njerëzore. Shprehja e rilindasve tanë se shqipja është gjuhë perëndie që e gjejmë te Naimi: “si gjuhë perëndie” tregon se shqipja është gjuha që shprehu e para përmasën hyjnore që nuk njihej deri atëherë në jetën njerëzore, të paktën për këtë hapësirë që sot njihet si gadishulli Ballkanik. Nuk gjen në të gjithë kontinentin evropian tempull më të vjetër se ai i Dodonës. Pra Dodona nuk është vatra e lindjes së shoqërisë njerëzore vetëm për Ballkanin, por është njëkohësisht edhe për vetë kontinentin evropian. Hyjnia e tyre ishte zot jo vetëm i jetës tokësore, por edhe i asaj qiellore. Njeriu në këtë mënyrë e shihte veten si pjesë e universit, pjesë e të cilit ishte edhe planeti ku ata banonin.

Si bëhej identifikimi i pellazgut në të shkruar dhe në skulptura

Në të shkruar një pellazg dallohej nga të tjerët se i vihej epitetit dios, që do të thotë se ishte adhurues apo pasardhës i hyznisë Di. Kur bëhej fjalë për një skulpturë pellazgut i vihej një qeleshe në kokë. Po qeleshja gjendet plotësisht edhe në atë territor që quhej Iliri. Kjo vërteton se pellazgët dhe ilirët i kanë përkurur së njëjtës etnie. Iliria dhe Pellazgjia janë baras me gadishullin Ballkanik që atëhere quhej gadishulli Ilirik.

Fig. - 5 Dioskurët me qeleshe

Kjo shtrirje kaq e gjerë tregon se hyjnia e Dodonës ka qenë e adhuruar si të pellazgët ashtu dhe të ilirët. Ashtu si në kohët e sotme, kur njerëzit e një kombi identifikohen me flamurin, në antikitet ata identifikoheshin me Hyjninë. Ata i vendosën hyznisë së tyre qeleshen dhe këtë e bënë pjesë të veshjes së tyre. Në kohën e Luftës së Trojës (shekulli i II para Krishtit) Dodona ishte me tempull e faltore me famë të madhe, përmendur nga Homeri të “Iliada” dhe “Odisea”. Që do të thotë se themelimi i saj e kapërcen mijëvjeçarin e II-të duke hamendësuar mijëvjeçarin e IV-III para Krishtit. Çfarë del pas kësaj lidhjeje apo vazhdimësie gati 5 mijëvjeçare, që kur njerëzit i vunë hyznisë së tyre qeleshen dhe e kanë mbajtur në kokë për më shumë se pesë mijë vjet. Kjo tregon se kemi të bëjmë me të njëjtën popullsi, që i ka besuar së njëjtës hyjnie deri në fund të shekullit të IV-ërt të erës sonë, kur Dodona u shkatërruar nga perandoria romake. Në këto 1500 vjet, kur besimi dodonas u zëvendësua dalëngadalë nga besimi i krishterë e ai mysliman, gjurmët e hyut të Dodonës ruhen ende në malin e Tomorit dhe tek adhurimi për lirin e shenjtë. Qeleshja shqiptare bën lidhjen më të mirë midis dy skajeve më të largëta kohore tek shqiptarët. Me hyun e Dodonës fillon zanafilla e shoqërisë njerëzore në këto brigje të Mesdheut. Shqiptarët e sotëm që janë krenar për qeleshen e tyre e gjejnë zanafillën e identitetit të tyre tek Dia i Dodonës, që do të thotë se jemi ai popull që kur erdhën helenët në këto troje, e identifikuan popullsinë që gjetën si të *lindur nga dheu*, që do të thotë se popullsia pellazge nuk identifikoheshin si e ardhur nga ndonjë hapësirë tjetër.



Homeri Akilin dhe Odisenë i ka dalluar nga të tjerët duke u vënë mbiemrin dios. Kështu që të vargu i shtatë i Iliadës kemi: *dios Akilleus*, po kështu edhe për Odisenë tek “Odisea” *dios Odisea*, që do të thotë se Akili dhe Odisea ishin pasardhës të hyznisë Di. Edhe vetë dy binjakët e Hyznisë mbajnë mbiemrin dios dhe ata quhen Dioskuri apo në shqip Dioskurët, që do të thotë Kurët e Dios. Nëse fjala *kurët* ka patur kuptimin binjakët ky emër do të thotë binjakët e Dios. Pra pellazgu dallohej në të shkruar nga mbiemri *dios* dhe kur u bëhej portreti në skulpturë atyre u vihej një qeleshe në kokë, ashtu siç e gjejmë Akilin dhe Odisenë me qeleshe në kokë.


Helenët për të krijuar identitetin e tyre e përfytyruan Zeusin pa qeleshe

Në antikitet njerëzit e kanë patur shumë të fortë ndjenjën e identitetit, karakteristikat me të cilat ata do të dalloheshin midis popujve të tjerë. Herodoti, i cili ka dhënë një përkufizim se çfarë ishte identiteti, thotë se

njerëzit e së njëjtës etnie kanë gjuhën dhe prejardhjen të përbashkët, nderojnë të njëjtat faltore dhe kanë zakone të përbashkëta.

Fig. - 6 Zeusi helen, ne Olimpia të Greqisë, pa qeleshe

Helenët vërtet e morën mitologjinë dhe hyjnitë nga pellazgët, por ata nuk mund t'i merrnin hyjnisë së Dodonës edhe qeleshen që ishte shenja dalluese e identitetit të shqiptarëve. Ndaj Zeusi helen është pa një qeleshe në kokë. Zeusi i Fidias në Olimpian e Peloponezit, i lartë rreth 12 metra, nuk e ka në kokë qeleshen e shqiptarëve. Ai është i ndryshuar dhe është shumë larg Dias së Dodonës. As njerëzit që ndodhen në këtë monument nuk e mbajnë një qeleshe në kokë, çfarë do të thotë se helenët e krijuan Hyjninë në modelin e tyre.



PËRFUNDIME

1. Qeleshja ka një shtrirje të gjerë gjeografike, ajo përputhet me të gjithë hapësirën ku banojnë sot shqiptarët.
2. Në antikitet, përveç shumë gjetjeve arkeologjike, dokumentohet edhe me tri gjetjet arkeologjike në luginën e Carakovistës, ku njëra i përket një qytetari të Epirit, e dyta një ushtari të ushtrisë epirote, kurse e treta Hyut të Dodonës që ishte Dia.
3. Gjetja arkeologjike në Luginën e Carakovistës dhe në Apolloni tregon se Dia i Dodonës mbante në kokë një qeleshe. Përhapja e gjuhës në një territor të caktuar gjeografik ka një vatër ku ajo është ngjizur dhe ka shërbyer për një kohë të gjatë si burim edhe për fjalët e reja që krijoheshin.
4. Në trojet pellazgo- ilire Dodona, si qendra fetare më e vjetër, shërbeu me modelin e saj të sistemit të hyjnive edhe te helenët e ardhur më vonë që u vendosën në tokën e pellazgëve, por edhe te romakët që përdorën sistemin e perëndive të Dodonës.
5. Që Dodona është qendra ku u formua gjuha shqipe vërtetohet nga qeleshja. Të folurit shqip dhe qeleshja kanë të njëjtën vatër të krijimit të tyre. Njerëzit e Dodonës nderonin hyjninë e tyre që ishte Dia. E adhuronin dhe donin ta strukturonin shoqërinë në modelin e tij. Hyjnia Di përbënte pjesën themelore të identitetit të tyre.
6. Edhe pse me rritjen e popullsisë vendbanimet e tyre ishin gjithnjë e më larg nga Dodona, dy elementët kryesorë të identitetit të tyre: gjuha dhe adhurimi për hyjninë Di mbeteshin për ta të patjetërsueshme.
7. Çdo pellazg apo ilir, sado larg që të ishte, ktheheshin në Dodonë, në vatrën e tyre, me dy elementët kryesorë të identitetit të tyre: gjuhën dhe qeleshen e bardhë. Kështu gjuha e Dodonës që përmirësohej vazhdimisht dhe qeleshja e bardhë u shtrinë në një territor gjeografik sa vetë gadishulli ku ata banonin dhe që në antikitet quhej gadishulli Ilirik.
8. Kështu dodonasi me qeleshen e bardhë, në rrjedhë të historisë nuk harroi as gjuhën e folur që sot identifikohet me shqipen, as qeleshen e bardhë që çdo familje shqiptare e kishte pjesë të veshjes së tyre, traditë që vazhdon deri në ditët e sotme.

9. Qeleshja është pjesa më e rëndësishme e identitetit tonë kombëtar. Ka përmasën historike që shkon deri në zanafillë të shqoqërisë pellazgo-ilire dhe shtrirjen më të gjerë gjeografike deri në skajet më të largëta të banuara sot nga shqiptarët.
10. Nuk gjendet territor i banuar nga shqiptarët që të mos e ketë qeleshën simbolin e krenarisë së tij kombëtare.

STUDIME MBËSHTEËSE DHE REFERENCA

- 1- Konstantin Karapanos, Dodonë e ses ruins, Paris 1878, Planche nr. X, (2)
- 2- Konstantin Karapanos, Dodonë e ses ruins, Paris 1878, Planche nr. XII (4)
- 3- Konstantin Karapanos, Dodonë e ses ruins, Paris 1878, Planche nr. Planche XV (4)
- 4- Apolonia përmes artit dhe teknologjisë (Statujë e Dias së Dodonës. Objekti është gjetur në Apoloni nga arkeologu Leon Rey, në akropolin e qytetit antik të Apolonisë. Njëra dorë e tij nuk ruhet, ndërsa tjetra ka patur në dorë rrufenë, armën e tij.
Zeusi i Fidias në Olimpia.